Ne nuk e merrnim në konsideratë gjakun e turbullt apo të verdhë që dilte pas pastrimit

Nga Umu Atijeh (Allahu qoftë i kënaqur me të!), e cila i pati dhënë besën Pejgamberit (paqja qofët mbi të!) përcillet se ka thënë: "Ne nuk e merrnim në konsideratë gjakun e turbullt apo të verdhë që dilte pas pastrimit".

[Sahih] [رواه أبو داود بهذا اللفظ ورواه البخاري بدون زيادة (بعد الطهر)]

Sahabija Umu Atijeh (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se gratë në kohën e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) nuk i konsideronin pjesë të menstruacioneve sekrecionet që anonin nga ngjyra e zezë apo e verdhë, që dilnin nga organi gjenital i femrës pas pastrimit nga menstruacionet. Kështu që ato nuk e linin namazin dhe as agjërimin për shkak të tyre.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/10014